



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/21 Ref.: 3025/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Edukim në Muzikë, BA, 240 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik.
 - Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc, 120 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik.
- II. Akreditohen programet e studimit, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Informatika në Biznes, MSc, 120 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Menaxhim Mjedisi, MSc, 120 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik.
 - Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc, 120 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik.
- III. Nuk akreditohen programet e studimit:
 - Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm, MSc, 120 ECTS.
- IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit
- V. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më 15 nëntor 2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Edukimi në Muzikë, BA, 180 ECTS Ri-akreditim	Astrit Pallaska Syzana Jakupi Arsim Kelmendi Alba Muçolli - Dehiri
2	Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc, 120 ECTS Ri-akreditim	Theranda Beqiri Vehbi Miftari
3	Informatika në Biznes, MSc, 120 ECTS Akreditim	Edmond Beqiri Vehbi Ramaj
4	Menaxhim Mjedisi, MSc, 120 ECTS Akreditim	Mimoza Hyseni Albona Shala
5	Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc, 120 ECTS Akreditim	Agim Rysha Astrit Bilalli Baki Koleci
6	Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm, MSc, 120 ECTS Akreditim	Bekë Kuqi Behrije Ramaj

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 18.03.2021, 25.03.2021 dhe 29.03.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Nana Dikhaminjia, Sanja Kalambura, Domagoj Vugić, Marina Novak, Draženka Komes, Delia Gologan, Marina Gregorić, Asnate Kažoka, Dražen Vrhovski, Josip Mikulić.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të ekspertëve ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit **Edukimi në Muzikë, BA, 180 ECTS** - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) kapitull, substancialisht dy (2) kapituj dhe pjesërisht tri (3) kapituj.

2. Për programin e studimit **Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc, 120 ECTS** - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tri (3) kapituj.

3. Për programin e studimit Informatika në Biznes, MSc, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht tri (3) kapituj dhe substancialisht katër (4).
4. Për programin e studimit Menaxhim Mjedisi, MSc, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) kapituj dhe pjesërisht një (1) kapitull.
5. Për programin e studimit Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) kapituj dhe pjesërisht dy (2) kapituj.
6. Për programin e studimit Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm, MSc, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht një (1) kapitull dhe pjesërisht pesë (5) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.